



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Tabela paraprake e vlerësimit të fakteve/vlerësimit nga monitorimi		Datë: 09.01.2018	Numri i seancës për këtë çështje: 1
<i>Ky monitorim u realizua në kuadër të projektit nr.2 "Për të rritur transparencën, gjithëpërfshirjen dhe përgjegjshmërinë në procesin e Vettingut" – projekt i mbështetur financiarisht nga Fondacioni për Shoqërinë e Hapur Shqipëri (OSFA) dhe zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH).</i>			
A. Informacioni bazë			
Institucioni dhe tema:	<i>Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, seanca dëgjimore e subjektit të rivlerësimit</i>		
Emri i subjektit të rivlerësimit	<i>Gentjan Jahjoli</i>		
Pozicioni i punës/ qyteti nëse nuk është Tirana	<i>Këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë. Ky subjekt i nënshtrohet rivlerësimit për shkak të funksionit të tij në Gjykatën e Lartë, neni 179/b pika 4 e Kushtetutës.</i>		
A u shty seanca dhe a ishte e arsyeshme kjo shtyrje?	<i>Seanca u shty për dhënien e vendimit për në datë 09 Dhjetor, ora 10.00 dhe trupi gjykues nuk paraqiti asnjë arsye për këtë shtyrje.</i>		
paraqisni arsyet në mënyrë të përmbledhur)	<i>Vendimi nuk u shpall në përfundim të seancës dëgjimore, në kundërshtim me nenin 55 pika 6 të ligjit 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve".</i>		
B. Aktorët që marrin pjesë në proces/seanca			
Trupa gjykuese (emrat)	Trupi gjykues: Firdes Shuli, kryesuese, Etleda Çiftja, relatores, Pamela Qirko, anëtare		
Monitoruesit ndërkombëtarë (emrat)	Z. John Leonardo		
Mbrojtje me avokat apo mbrojtje personalisht (specifikoni)	Personalisht		
Anëtarë të tjerë të publikut të pranishëm?	10 anëtarë nga publiku. Seanca u monitorua edhe nga një vëzhgues i Avokatit të Popullit.		
Media e pranishme:	Në sallën ku u zhvillua seanca dëgjimore u vu re një numër i vogël i përfaqësuesve të medias. Kështu, seanca u monitorua nga përfaqësues të medias së shkruar, (BIRN, dhe Gazeta Shekulli) dhe u vërejtën disa operatorë të medias që video- regjistruan çeljen e seancës dëgjimore.		
C. A vendosi institucioni i vettingut apo bazuar vetëm në një apo dy prej tyre?	<i>Po</i>	<i>Nëse po, si u justifikua ai?</i>	<i>Nëse po, si ka reaguar subjekti ndaj kësaj ?</i>
	Rivlerësimi i këtij subjekti u krye në bazë të të tri kriterëve: pasuria, figura dhe aftësitë profesionale.		

D. Përmbajtja e çështjes (Vlerësimi i kriterëve)	Argumenti	kush e ka dhënë argumentin	A u diskutua? Prova? A u kalua barra e provës?
D1. Pasuria	Në lidhje me këtë kriter, relatorja e çështjes paraqiti rezultatet e vlerësimit të institucionit ndihmës, ILDKPKI, i cili kishte konstatuar pozitivisht lidhur me deklarin dhe ligjshmërinë e të ardhurave që justifikojnë pasuritë e subjektit, si dhe mungesën e situatës së konfliktit të interesit.	ILDKPKI	Po barra e provës u kalua sipas ligjit
	Në përfundim të hetimit KPK ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit disponon pasuritë si më poshtë: 1. Llogari bankare rrjedhëse, (shuma në këtë llogari nuk u bë e ditur nga KPK), për të cilën subjekti ka deklaruar se këto kursime kanë buruar nga pagat dhe shpërblimet e tij si: i. këshilltar ligjor në Gj.L që prej 2014; ekspert i Sekretariatit Teknik për reformën në drejtësi; iii. pedagog i jashtëm në Universitetin privat "Iliria". 2. Apartament 151m2 në Tiranë, plus 2 shtesa të realizuara ndër vite, në pronësi të prindërve të subjektit, ku ai jeton. Lidhur me këtë pasuri, subjekti ka deklaruar burimet nga puna e babait si taksist i licensuar. 3. Kartë krediti, sipas limitit të bankës. KPK u shpreh se u pa se deklarinimet e subjektit të rivlerësimit që janë në përputhje me realitetin. Pasuritë e personave të lidhur 4. Automjet BMW, në vlerën 500 Euro, blerë në vitin 1991, për të cilën ka rezultuar si subjekti dhe babai i tij, kanë pasur të ardhura të ligjshme për ta blere atë. 5. Llogari bankare në shumën 4,713 Euro në emër të nënës së subjektit të monitorimit. Në lidhje me këtë, subjekti ka deklaruar se ka buruar nga dërgesat ndër vite nga motra e subjektit në Itali. Shpenzimet Lidhur me shpenzimet e doktoraturës në Itali, (pagese 1700 Euro) KPK u shpreh se fillimisht nuk kishte rezultuar i qartë burimi, por pas kalimit të barrës së provës subjekti ka dhënë shpjegime bindëse. Vërehet se KPK nuk përmendi ndonjë tabelë të analizës financiare me bilancet përkatëse ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve vit pas viti për këtë subjekt.	Relatori	
	n/a	Mbrojtja	
	Subjekti u shpreh dakord me konstatimet e relatorit	Subjekti	
	asnjë	Ankesa nga publiku	
	asnjë	ONM	
D2. Figura /Kontaktet me krimin e organizuar	Relatorja e çështjes u shpreh se për këtë kriter organi ndihmës, DSIK në raportin e tij kishte konkluduar pozitivisht për përshtatshmërinë e figurës së këtij subjekti të rivlerësimit për të vazhduar detyrën sipas ligjit.	Të dhëna nga raportet e DSIK	JO, pasi subjekti nuk u gjet ne situatë të shkeljes disiplinore, për shkak të kriterit të figurës
	Relatorja u shpreh se pas hetimit të KPK, bazuar në raportin e DSIK dhe verifikimit të deklaratës së figurës, dhe burimeve të tjera ka konkluduar se subjekti ka bërë deklarinim të saktë, nuk ka fshehur kontakte të papërshtatshme dhe është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.	Relatori	
	n/a	Mbrojtja	
	Subjekti u shpreh dakord me konstatimet e relatorit	Subjekti	
	asnjë	Ankesa nga publiku	
	asnjë	ONM	

D3. Vlerësimi i aftësive profesionale dhe etikës	Relatorja e çështjes u shpreh se Inspektorati i KLD e ka vlerësuar pozitivisht subjektin, në lidhje me aftësitë profesionale. Gjithashtu subjekti ka marrë 62 pikë në testimin pranë Shkollës së Magjistraturës, pra më shumë se 60% të pikëve.	Raporti i hollësishëm i Inspektoratit të KLD. Rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës	JO, pasi subjekti nuk u gjet në situatë të shkeljes disiplinore, për shkak të kriterit të aftësive profesionale
	Relatorja u shpreh se KPK, bazuar në raportin e Inspektoratit të KLD, rezultatin e testimit në SHM, dhe burime të tjera të administruara prej saj, në bazë të kriterëve të Ligjit për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve ka konstatuar se subjekti është "i aftë".	Relatori	
	Subjekti u shpreh dakord me konstatimet e relatorit.	Subjekti, etj..	
E. Konkluzione dhe komente të monitoruesit të KSHH (Vlerësimi paraprak i monitoruesit të KSHH për aspektet e procesit të drejtë ligjor (publiciteti, etika e organeve të vettingut dhe përfaqësuesit të OMN, si e vlerësoni hetimin administrativ, të drejtat e mbrojtjes së subjektit, barazia e mjeteve ligjore, parimi i kontradiktoritetit, koha e arsyeshme, e drejta për të paraqitur prova dhe e drejta për tu dëgjuar, etj.)	<p>Lidhur me parimin e publicitetit të gjykimit</p> <p>Konstatohet, veçanërisht lidhur me kriterin e pasurisë, se gjatë seancës dëgjimore trupi gjykues bëri një përshkrim jo të plotë të rrethanave, fakteve, dhe gjetjeve të KPK, si dhe provave dhe kundër-argumenteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit.</p> <p>Kështu, në lidhje me pasurinë nr.1 nuk doli e qartë në seancë se sa ishte shuma e kësaj depozite rrjedhëse, dhe as analiza financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve që solli përfundimin e justifikimit me të ardhura të ligjshme. Edhe për pasurinë nr. 2 nuk doli e qartë vlera e apartamentit dhe analiza financiare përkatëse. Po kështu, në lidhje me pasuritë nr. 3 dhe nr. 4 nuk u përmendën të ardhurat konkrete dhe analizat financiare përkatëse.</p> <p>Edhe në lidhje me shpenzimet për doktoraturën në Itali nuk doli i qartë totali i tyre, dhe se si ishin justifikuar ato me burime të ligjshme.</p> <p>Gjithashtu u vu re se në momentin kur fjala i kaloi subjektit të rivlerësimit atij iu sugjerua të "mos kalonte në përsëritje" pasi trupa i kishte marrë tashmë argumentet dhe provat e tij me shkrim. Kjo praktikë vjen në kundërshtim me parimin e publicitetit të seancës, i cili nënkupton paraqitjen e të gjitha rrethanave, provave dhe argumenteve të lidhura me objektin e procesit, të të dyja palëve, publikisht dhe verbalisht. Në këtë mënyrë realizohet edhe qëllimi i kësaj garancie procedurale që është ta bëjë të dukshme për publikun administrimin e drejtësisë, për të garantuar një gjykim të drejtë (Malhous k. Republikës Çekezech [GC], §§ 55-56).</p> <p>Lidhur me parimin e proporcionalitetit dhe standardeve të njëjta</p> <p>Lidhur me pasurinë nr. 5 KPK vendosi një nivel të ulët të provueshmërisë, bazuar vetëm në deklarinim e subjektit, pa kërkuar apo iu referuar në seancë dokumenteve që e provonin këtë fakt dhe ligjshmërinë e të ardhurave të motrës së subjektit në Itali.</p> <p>Koment i përgjithshëm</p> <p>Gjatë fjalës së saj relatorja e çështjes lexoi me shpejtësi rrethanat e çështjes dhe rezultatet e hetimit të KPK, duke e bërë të vështirë ndjekjen, të kuptuarit e fakteve dhe rrethanave, por edhe regjistrimin e tyre për t'ia përcjellë më pas publikut.</p>		